



Tirane ▾

00:00 am

00:00

KRYESORE

POLITIKË

AKTUALITET

EKONOMI

KULTURË & ARTE

FCB-BOMB

RAJON

SPORT

BOTA

SHOWBIZ

'Haxhi Baçinozi e goditi i pari', zbardhet DËSHMIA e të arrestuarit, mik me autorin e vrasjes te Liqeni

Publikuar tek: **AKTUALITET**, më 15:59 17-03-2019



Zbardhet dëshmia e Myftar Pashës, të arrestuarit për vrasjen e 62-vjeçarit Haxhi Baçinozi.

Myftar Pasha, mik me autorin e vrasjes Islam Myrtaj, akuzohet për moskallëzim krimi, ndërkohë që në polici ka dëshmuar se ka qenë me autorin në momentin e vrasjes.

“Islam Myrtajn e kam shok dhe komshi. Te shtunën pasdite me mori ne telefon me pyeti ku je. I thashë po dal nga liqeni dhe ai erdhi me shoqëroi. Ishim duke ecur te dy kur përballë pame Haxhi Baçinozin me te birin. Islami me tha “boo kush duron kete, do me kujtoje leket”.

Kur Haxhiu u afrua e ofendoi Islamin rende dhe e goditi. U perleshën te 2 dhe pastaj Islami nxori pistoletën dhe qelloi 4 ose 5 here. Sapo qelloi Islami u drejtua drejt kodrës. Ndodhi shumë shpejt. Unë nuk kisha dijeni që Islami kishte arme dhe që do e vriste. U tremba shumë dhe shkova direkt në shtëpi. Sot u qetësova dhe mora kontakt me policinë”, thuhet në dëshminë e


newsbomb
160K likes

Like Page



LIVE

352



Kliko këtu për të parë videot



BOMB VIDEO



Shëndet paç me
Oledro



Hot

GRIP
FTOHJE
KOLË

Pashës të siguruar nga BalkanWeb.

Kujtojmë se vrasja ndodhi mbrëmjen e djeshme rreth orës 18:15 pranë një shkolle private, ndërkohë që 62-vjeçari Haxhi Baçinozi ka qenë duke vrapuar me djalin e tij 14-vjeçar.

Sipas burimeve nga policia shkaku që çoi në vrasjen e 62-vjeçarit ishte një borxh i pashlyer i viktimës ndaj autorit.

Po ashtu bëhet e ditur se ka qenë djali i 62-vjeçarit i cili ka identifikuar menjëherë autorin.

Dinamika e ngjarjes:

Atentati ka ndodhur rreth orës 18:15 pranë një shkolle private, ndërkohë që 62-vjeçari Haxhi Baxhinovski ka qenë duke vrapuar me djalin e tij 14-vjeçar.

Dy persona të maskuar dhe të veshur me xhupa të zinj janë afruar me motor dhe kanë qëlluar 5 herë, por vetëm tre prej plumbave kanë kapur trupin e viktimës.

62-vjeçari është dërguar me shenja jete në spitalin e Traumës, por nuk ka mundur t'i mbijetojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë.

Bëhet me dije se ashtu si viktimë edhe dy autorët ishin me origjinë nga Fieri, ndërsa djali i mitur i Baxhinovskit ka mundur të identifikojë dy atentatorët si shtetasit me initiale I.M. dhe I.H.

Gjithashtu është bërë e ditur se viktimë është ish i përndjekur politik për agjitacion dhe propagandë, por vitet e fundit ishte shpërblyer nga shteti.


62-vjeçari jetonte prej disa vitesh në Tiranë dhe nuk njihej si një person problematik, ndërkohë dyshohet që shkak i atentatit të ketë qenë një konflikt i ndodhur gjatë kohëve të fundit.

Dyshohet se pas vrasjes autorët janë larguar me motor drejt Saukut.

Modifikuar më 16:04 17-03-2019

SONDAZH

Pas dorëheqjes së Sandër Lleshajt, kush mendon se duhet të jetë ministri i ri i Brendshëm?



HOROSKOPI 2020

SHTYPI I DITËS

